




# Cilat janë sfidat e të qenit i/e re në Kosovë?




1. **Të rinjtë në Kosovë** përballen me një shkallë të papunësisë prej 49.4%, teksa gratë në moshë të re janë shumë të rrezikuara, me një shkallë të papunësisë prej 60.3%, krahasuar me burrat, me shkallë të papunësisë prej 44.1%.  
(Source: Kosovo Agency of Statistics).



2. **Të rinjtë** e moshës 15-19 vjeç përbëjnë rreth një të pestën e fuqisë punëtore. Sidoqoftë, para vitit 2019, ata përbënin vetëm një pjesë të vogël të fuqisë punëtore, sikurse në vitin 2014, kur pjesëmarrja e tyre ishte 15%. Shkalla e lartë e papunësisë tek gratë në moshë të re është alarmante (60% në vitin 2019), në krahasim me burrat në moshë të re (44% në vitin 2019).  
(Source: Kosovo Agency of Statistics).



3. **59% e të rinjve të moshës 18 – 24 vjeç në Kosovë** do të dëshironin të largoheshin nga vendi (Instituti Demokratik Kombëtar, 2019).  
**Në vitin 2018, vetëm 21%** e të rinjve të moshës 14 - 29 vjeç, e konsideruan veten shumë të kënaqur me cilësinë e edukimit.  
(Source: Friedrich-Ebert Stiftung, 2018/2019).



4. **Nxënësit** nga komuniteti rom, ashkali, egjiptian dhe goran kanë pjesëmarrje të ulët në arsimin e mesëm të lartë, në shkollat publike. Gjatë vitit shkollor 2019/2020, vetëm 182 romë, 259 ashkali, 137 egjiptianë dhe 11 goranë vazhduan shkollimin në shkollën e mesme të lartë, në krahasim me 75,674 shqiptarë.  
(Source: KAS. Education Statistics in Kosovo).

5. **PËRQINDJA E TË RINJVE QË JANË JOAKTIVË ËSHTË MJAFT E LARTË**



**Përqindja e të rinjve** që janë joaktivë (të papunë, nuk vijnë shkollën dhe nuk marrin pjesë nëpër trajnime) është mjaft e lartë, duke arritur 1/3 e popullatës së re në Kosovë për disa vite me rradhë (Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2012-2018). Në vitin 2019, Kosova ka pasur shkallën më të lartë të të rinjve joaktivë (32.7%) në Ballkanin Perëndimor, duke u pasuar nga Shqipëria dhe Bosnja dhe Hercegovina me 25.8%, përkatësisht 21.2%.  
(Kosovo Agency of Statistics, Source: World Bank)

**Vetëm rreth 10% e të rinjve në Kosovë konsiderojnë se interesat e tyre përfaqësohen plotësisht në politikat kombëtare.**  
(Source: Friedrich-Ebert Stiftung, 2018/19)

# Cilat janë sfidat e të qenit i/e re në Kosovë?



6.

**Të rinjtë** e moshës 15-24 vjeç kryesisht punojnë nëpër industrinë siç janë aktivitetet e shërbimeve, tregtia me shumicë dhe pakicë, si dhe sektori i ndërtimit, ku burrat kanë një pjesëmarrje më të lartë në punësim sesa gratë në moshë të re, në pothuajse të gjitha industrinë me shkallë të lartë të punësimit.  
(Source: Millennium Challenge Corporation).




7.

**Rreth 56% e të rinjve** punojnë nëpër profesione të cilat nuk përputhen me kualifikimet e tyre arsimore, teksa më shumë se gjysma e të anketuarve konsiderojnë se njohuritë në fushën përkatëse dhe/ose lidhjet e afërta me njerëzit që janë në pushtet janë faktorë shumë të rëndësishëm për të gjetur një vend pune.  
(Source: Friedrich-Ebert Stiftung, 2018/19).

8.

**Barrierat më të shpeshta që pengojnë punësimin e të rinjve të cilët jetojnë nëpër zonat rurale janë:**



**Prej të rinjve** të moshës 15 – 24 vjeç të cilët jetojnë në zonat rurale të Kosovës, 80.5% të grave janë të papunësuara, në krahasim me 67.6% të burrave.  
(Source: NGO LENS).



**17.9%**  
mungesa e vendeve të përshtatshme të punës



**14.3%**  
mungesa e transportit adekuat për të shkuar në punë



**14.3%**  
mungesa e fleksibilitetit në orarin e punës



**14.3%**  
mungesa e vendeve të punës me orar të shkurtuar



**14.2%**  
mungesa e kohës për shkak të kujdesit të familjes/fëmijëve



**10.7%**  
mungesa e vetëbesimit për ta kryer punën



**7.1%**  
mungesa e mbështetjes familjare dhe kualifikimi joadekuat



**81.4%**  
e të rinjve të zonave rurale varen nga prindërit e tyre nga aspekti i burimit të të ardhurave